



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2765 Prot

Vlorë, më 23 . 12 .2025

VENDIM

Nr. 23 , datë 22 . 12 .2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË
Nr. 20, DATË 29.12.2021 “MBI CAKTIMIN E SISTEMIT TARIFOR PËR
DOKUMENTACIONE QË DALIN NGA ARKIVI I ADMINISTRATËS SË
KËSHILLIT TË QARKUT VLORË”**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 22 . 12 .2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 20, datë 29.12.2021 “Mbi caktimin e sistemit tarifor për dokumentacione që dalin nga Arkivi i administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë”,

VENDOSI;

1. Të bëhen ndryshime në tarifatat për akte të konfirmuara që do të dalin nga arkiva e administratës së institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë, dhe tarifatat e reja do të jenë :
300 (treqind) lekë tarifa e pranimit,
200 (dyqind) lekë/fletë formati A4,
400 (katërqind) lekë/fletë formati A3
2. Pagesa e tarifave do të bëhet në një Bankë të Nivelit të Dytë dhe mandatet e pagesave do të bashkëlidhen me kërkesën e aplikuesit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës/Zhvillimit Ekonomik dhe Social në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3 të Nenit 78, të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

KRYETARI

Ervis Moçka



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. 1245 Prot, datë 05 . 01 . 2025

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 20, datë 29.12.2021 “Mbi caktimin e sistemit tarifor për dokumentacione që dalin nga Arkivi i administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë” si dhe duke patur parasysh përvojën e këtyre viteve po Ju parashtrojmë si më poshtë:

Që prej miratimit të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 20, datë 29.12.2021 “Mbi caktimin e sistemit tarifor për dokumentacione që dalin nga Arkivi i administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë”, është konstatuar shtimi i kërkesave për dokumentacion arkivor (kopje aktesh) në arkivin e administratës duke shmangur rrugën për të paraqitur kërkesat kryesisht pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës rrjedhimisht edhe tarifat për shërbimet e ofruara nga DAMT, tarifa këto të vendosura me Urdhërin Nr. 183, datë 26.05.2011 “Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark” të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Shmangia e paraqitjes së kërkesave në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, shmang pagesat sipas Urdhërit Nr. 183, datë 26.05.2011 “Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark”, paraqitjen e kërkesave për marrjen e dokumentacionit të njësuar me origjinalin nga drejtoria përkatëse që e administrojnë dokumentacionin si dhe shton punën kërkuese në zyrën e arkivit të administratës, përgatitjes së përgjigjes dhe si punën për procesin e shumëfishimit të dokumentacionit arkivor.

Referuar për sa më lart duke marrë parasysh të gjitha arsyet, kërkojmë një rritje të tarifave për kopjet e akteve të konfirmuara që dalin nga arkiva e administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë si më poshtë:

Ishte

300 (treqind) lekë tarifa e pranimit,
100 (dyqind) lekë/fletë formati A4
200 (katërqind) lekë/fletë formati A3

Bëhet

300 (treqind) lekë tarifa e pranimit
200 (dyqind) lekë/fletë formati A4
400 (katërqind) lekë/fletë formati A3

Pagesa do të bëhet në një Bankë të Nivelit të Dytë dhe akti i konfirmuar do të vendoset në dispozicion kërkuarit vetëm pasi të ketë kryer pagesën e plotë të detyrimit.

Drejtor i Drejtorisë së Financës/Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Jurist

Alma Myrtaj